

**AKT THEMELIMI**  
**I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**

**Cleaners Services**

Sot, më datë 20.02.2024, personalisht:

Francesco Giovanni Mosca, atesia Adler Mosca, shtetas italian, lindur ne Torino, Itali dhe banues ne Villafranca Piemonte, lindur me 28.03.1956, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me karte identiteti me Nr. CA96976GX

Përpilon këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare **Cleaners Services sh.p.k.**, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Të themelojë Shoqërinë Tregtare **Cleaners Services SH.P.K.**, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri Cleaners Services SH.P. K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

**NENI 2 Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

**NENI 3 Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit Cleaners Services SH.P. K, me emrin tregtar I.C.S. dhe ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4 Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria, në përputhje me dispozitat dhe kufizimet e ligjit, ka për objekt veprimtaritë e mëposhtme:

Pastrimi i përgjithshëm i ndërtesave dhe objekteve industriale si dhe aktivitete te tjera pastrimi.

Tregtia me shumicë e artikujve të parfumerisë dhe kozmetikës si dhe tregtia me pakicë e artikujve kozmetikë dhe të tualetit në dyqane të specializuara. Tregtia me pakicë të artikujve jo në dyqane, tenda ose tregje të çdo lloj produkti nëpërmjet shitjeve direkte me shitës derë më derë, nëpërmjet



makinave që shesin etj, shitje me pakicë në dyqane jo të specializuara dhe tregtia me pakicë me porosi me mail ose nëpërmjet internetit.

Prodhimi i mobiljeve të kuzhinës dhe mobiljeve të tjera, punime për veshjen e dyshemeve dhe mureve, shtrimi me parket dhe të tjera veshjeve druri të dyshemeve, veshja e murit me elementë druri dhe aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e lëndës drusore dhe materialeve të ndërtimit.

Hotele, struktura të ngjashme, restorante dhe shërbim ushqimor i lëvizshëm.

Dhënia me qera dhe hua e mjeteve të transportit dhe kamioneve.

Shërbimet të flokeve dhe të bukurisë, manikyr dhe pedikyr, makiazi etj dhe aktivitete të spiritualitetit, tatuazhe dhe pirsing, shërbime të kujdesit të kafshëve etj.

Funksionimi i vendeve dhe ndërtesave historike të ngjashme tërheqëse për vizitorët.

#### **NENI 5 Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. Myrtezim Kellici, Pll. AL-FAM, Ap.23, Tiranë.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat.

#### **NENI 6 Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar është 100.000 (njqind mijë) Lek dhe zotërohet nga ortaku themelues.

Vlera totale e kapitalit të regjistruar: 100.000 leke

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1

Kapitali themeltar është mbuluar tërësisht nga ortaku i vetëm themelues.

#### **NENI 7**

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare **Cleaners Services SH.P.K** zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- Francesco Giovanni Mosca, pjesëmarrja me përqindje 100 %, 1 kuote, lloji i kontributit në para 100.000 leke.

Kapitali themeltar është mbuluar tërësisht nga ortaku i vetëm themelues.

#### **NENI 8 Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:



1. Ortaku i Vetem – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

#### **NENI 9 Administratori**

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë të shoqërisë do të jenë Znj. Gerta HASMUÇA.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, entit publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 10**

Ortaku mund të vendose me vullnetin e tij, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 11**

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

#### **NENI 12**

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

#### **NENI 13**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimi hartohet në gjuhën shqipe pasi ortaku është njohës i gjuhës shqipe.

### **ORTAKU I VETEM THEMELUES**

**Francesco Giovanni Mosca**

FRANCESCO GIOVANNI MOSCA

